



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-07/25
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	31.07.2025
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së shtatë (07) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 31.07.2025, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, nënkryetarin e Komunës së Junikut z.Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit me pas konstatoi se mbledhje marrin pjesë te 8 anëtarët e kuvendit. Në mbledhje nga drejtorët prezent ishin: znj.Leonora Shehu AD,znj.Vjollca Qestaj-DBF,z.Jetmir Jasiqi-DEZH, z.Zenun Shala DUKM, z.Fatos Shala-DSHMS, z.Demokrat Ganijaj-DSHPMSI.

Anëtarët prezent

- | | |
|---------------------------------------|--------------------------------------|
| 1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK | 10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK |
| 2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK | 11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK |
| 3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK | 12. Festina Maloku - Anëtare, AAK |
| 4. Mursel Salihaj-Anëtar,LDK | 13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV |
| 5. Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK | 14. Eliza Pepshi-Anëtare,LVV |
| 6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK | 15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV |
| 7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK | |
| 8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK | |
| 9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK | |

Rendi i ditës i paraparë

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën e dytë Janar-Qershor 2025
3. Shqyrtimi dhe Miratimi i Projekt Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha Komunale për vitin 2026 (leximi i dytë),
4. Njoftim me Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës për 6 mujorin e vitit 2025,
5. Shqyrtimi dhe Miratimi i Propozim Vendimit për Taksa Komunale të Ndërtimit për Vitin 2026,
6. Informatë mbi Raportin e Përfomancës së Administratës së Komunës së Junikut për vitin 2025,
7. Shqyrtimi i raportit dhe Analiza e vitit Shkollor 2024/2025,
8. Shqyrtimi dhe Miratimi i Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë,
9. Rishqyrtimi i Vendimit me nr:02-180/4898 për zgjerimin e Zonës Urbane në Komunën e Junikut, Miratuar nga Kuvendi Komunal Junik, dt:27.06.2025,
10. Shqyrtimi dhe Miratimi i Planit për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (leximi i dytë),
11. Shqyrtimi dhe Miratimi i Planit për Trashëgiminë Kulturore 2025-2030,
12. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit. dhe
13. Të ndryshme.

z.Shpejtim Gacaferi para se te hedhim në votim rendin e ditës kemi kërkesë që pika e 10 të hiqet nga rendi i ditës së sotme , si dhe kemi kërkesë nga kryetari i komunës qe si pikë e rendit të ditës te hynë kërkesa për faljen e borgjeve për biznese, si kërkesë nga drejtori i arsimit të hynë si pikë kërkesë per themelimin e institucionit parashkollor ne komune e Junikut, dhe kerkese tjetër kemi miratimin e dy antarve per zgjedhjen e drejtorit te institucionit parashkollor, une e qes ne votim rendin e ditës te propozuar per ditën e sotit, kush eshte per per 8 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, tani e qes ne votim rendin e ditës me këto kërkesa qe u bene.

z.Dervish Bajraktari, përshëndetje per te gjithë, une kisha dshte qe te dimë se deri ku kan shkuar procedurat per themelimin e institucionit parashkollor, qe te jemi me shume te informuar.

z.Xhavit Velijaj, pershendetje per te gjithe, pas kerkeses qe kemi bere ne ministrin e arsimit per pelqimin e themelimit te institucionit parashkollor, ministria na ka dhane peqimin por pas marjes se keti pelqimi Komuna e Junikut duhet te nxerre vendim per themelimin e keti institucioni parashkollor vendim qe duhet te meret nga kuvendi i Komunes.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese tjeter nuk ka une e qes ne votim rendin e dites me keto kerkesa te parashtruara, kush eshte per, per 8 vota, kunder 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se rendi i dites u miratua me kete renditje:

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje,

2. Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën e dytë Janar-Qershor 2025
3. Shqyrtimi dhe Miratimi i Projekt Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha Komunale për vitin 2026 (leximi i dytë),
4. Njoftim me Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës për 6 mujorin e vitit 2025,
5. Shqyrtimi dhe Miratimi i Propozim Vendimit për Taksa Komunale të Ndërtimit për Vitin 2026,
6. Informatë mbi Raportin e Përfomancës së Administratës së Komunës së Junikut për vitin 2025,
7. Shqyrtimi i raportit dhe Analiza e vitit Shkollor 2024/2025,
8. Shqyrtimi dhe Miratimi i Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë,
9. Rishqyrtimi i Vendimit me nr:02-180/4898 për zgjerimin e Zonës Urbane në Komunën e Junikut, Miratuar nga Kuvendi Komunal Junik, dt:27.06.2025,
10. Shqyrtimi i kërkesës për faljen e borxheve të biznesëve nga taksa e veprimtarisë,
11. Shqyrtimi dhe Miratimi i Planit për Trashëgiminë Kulturore 2025-2030,
12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë së Arsimit për themelimin e Institucionit parashkollor,
13. Shqyrtimi dhe miratimi për formimin e komisionit prej dy anëtarëve për zgjedhjen e drejtorit për institucionin parashkollor,
14. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit. dhe
15. Të ndryshme.

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,

Në këtë mbledhje mungojnë, z.Leonard Lllolluni-AAK, znj.Erleta Qestaj-AAK, znj.Lirjeta Shehu-LDK, znj.Ermelinda Lllolluni-LDK, z.Alfred Gaxherri-LDK, z.Xhemë Tofaj-LVV, ndersa z.Lulzim Gacaferi ka lajmruar se do të vijë me vonesë në mbledhje.

2. Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën e dytë Janar-Qershor 2025,

Raporti e beri znj.Vjollca Qestaj- drejtoreshë në DBF, e cila fillimisht i përshëndeti të gjithë me pas e raportoi kuvendin mbi financat për periudhën Janar-Qeshore 2025.

Gjate prezentimit të raportit të financave në sallë arrin edhe z.Lulzim Gacaferi e tash e tutje prezent në sallë janë 9 anëtarët e kuvendit.

z.Shpejtim Gacaferi, pyetje nuk ka, kalojmë në pikën e redhës.

3. Shqyrtimi dhe Miratimi i Projekt Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha Komunale për vitin 2026 (leximi i dytë),

Prezentimin dhe sqarimin e projekt rregullores për taksa, tarifa dhe gjoha komunale leximi i dytë e beri znj.Vjollca Qestaj- drejtoreshë në DBF.

z.Shpejtim Gacaferi, pyetje nuk ka, e qes ne votim projekt rregulloren per taksa, tarifa dhe gjoba komunale leximi i dytë, kush është per? për 9 vota , kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se projekt rregullorja për taksa, tarifa dhe gjoba komunale u miratua.

4. Njoftim me Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës për 6 mujorin e vitit 2025,

Njoftimin dhe sqarimin e raporti të punës së Kryetarit të Komunës për gjashtë (6) mujorin e vitit 2025, e bëri kryetari i komunës z.Ruzhdi Shehu i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë më pas njoftoj kuvendin për punën e tij për gjashtë mujorin e vitit 2025.

z.Lulzim Gacaferi, përshëndetje për të gjithë, unë ju përgëzoj për këto të arritura, por dua të ndalem tek shtrati i lumit Erenik, pse nuk e keni pa te udhës që ngritni padi ndaj atyre të cilët ndërtuan shtratin e lumit Erenik me një punë të përgjysmuar, e ku investimet për këtë shtrat të lumit kapin miljona euro, e ku shofim se ata persona lëvizin lirshëm, dhe prap kanë hyrë në garë për të marrë komunën dhe kërkojnë vota gjithëandej, e shtrati i lumit erenik është bartur ne lumin "Drini i bardhë", e askush nuk ka dhënë përgjegjësi për këtë punë, po ashtu u fol në këtë raport edhe për lagjen "Gacafer", unë e di se është hapur një tender për këtë lagje në vlerë prej 130000€, dhe po dua të di se çka keni paraparë që me këto 130000€ të ndërtoni në lagjen "Gacafer", dhe ne sa faza parashihet ky projekt të ndërtohet dhe a ka kompani që ka konkuruar ta merr këtë tender? u fol edhe për rrugën e asfaltuar për bjeshkë, ju pergezojë për këtë punë, kemi pritur shumë vite që kjo rrugë të asfaltohet, sepse është shumë e rëndësishme për Komunën e Junikut që atje të zhvillohet turizmi, isha në atë pjesë dhe e shikova që keni filluar të hapni rrugë për "stanishten e Goçajve", por unë kisha kërkuar që në bazë të mundësive që ka komuna, të hap rrugën edhe për stanishten e "Gacaferit" sepse ajo rrugë është tepër e keqe, po ashtu për rrugën qendër në drejtim të fshatit Rastavicë dihet që falë angazhimit tuaj si qeveri komunale dhe falë qeverisë Kurti që ju ka mbështetur kjo rrugë është përfunduar, po ashtu e ceket se ndriqimi publik po ka një kosto të lartë, po duaht të cekim se ne segmentin errugës për ne Rastavicë ka shtylla të ndriqimit shumë dhe kisha propozuar që energjija në atë pjesë të reduktohet në një shtyllë po nj, një shtyllë jo, po ashtu sa i përket kanaleve të ujitjes, ne si asamblast kemi kërkuar shumë here këtu në kuvend që ne pjesën e kallavajit ku janë tokat e banoreve të lagjes "Gacafer" por edhe të lagjeve tjera, bëhet fjalë për tek toka e z.Bajram Gacaferi, të ndërtohet një kanal që tju mundsohet ujitja e tokave por deri tani nuk keni ndërmarr asnjë hap, uroj që në të ardhmen të ndërmerrni hapa konkret dhe ky kanal i ujitjes të ndërtohet, pasi që ky ka qenë edhe premtim i yni.

z.Zenun Shala,pëshendetje për të gjithë, në qarkoren e qendrës kemi edhe një pjesë të rrugës "Shkelzen Gacaferi", tenderi vetem se është fituar dhe shumë shpejt do të fillojnë punët, ndërsa sa i përket rrugës nga qendra dhe ne lagjen "Gacafer", pra rruga "Shkelzen Gacaferi", ne kemi përgaditur tender për asfaltimin e saj, ndriqimin, trotuaret të gjitha janë të gatshme, për kete vite kemi një shume të vogël për të filluar, ndërsa sa i përket kanaleve të ujitjes ne kemi punuar me kopanin Drini i Bardhe dhe kjo kompani ka pru enje bage i cili ishte shume i madhe dhe nuk ka mundut të filloje hapjen e kanaleve për shkak të tonelatës së lart të keti bageri, mirëpo edhe përkundër kësaj ne në të ardhmen do të ndërtojmë këto kanale, projektet i kemi të gatshme por edhe përkundër kësaj ne do të shiqojmë mundësitë se aty ku ka nevojë të hapim kanale të ujitje në do ti bëjmë.

z.Ruzhdi Shehu, sa i përket shtratit të lumit "Erenik", vetë punimet e këtij shtrati tregojnë më së miri se a është berë punë cilësore, dhe të jeni të bindur se të gjitha argumentet që janë disponueshme do ti deponojmë te organet e drejtesisë dhe këto organe do te ndajnë drejtesinë jo ne.

z.Zenel Maloku, përshëndetje për të gjithë, unë e përkrahi z.Lulzim Gacaferi qe punë të shkojnë mirë dhe drejt, sa i përket shtratit te "Lumit Erenik", është për të ardhur keqë se ne qfar gjendje eshte ky shtrat, po ashtu eshte duke u përmendur shume rruga e bjeshkës, jo e kemi quar deri në "Gropë te Erenikut", une e di se rruga e bjeshkës nuk është përfunduar as deri në "Gropë të Erenikut" rruga ka afër 8 kilometra qe duhet ti ndërtohen anësoret, rruga për bjeshkë nuk është e ndërtuar as deri në Jasiq, rruga është ka shembet, nuk ka mbrojtëse anësore nuk është një korsi e gjerë, dhe si e tillë po qe se bie një shi apo një fluskë borë paraqet rrezik për qytetarët andaj unë po ju them që punët të kryhen mirë me fillim dhe rend, e jo të thuhet se rruga për bjeshkë është e përfunduar.

znj.Rajmonda Krasniqi, përshëndetje për të gjithë, unë pata një pyetje për rrugën e xhamisë së "Qokut", anesh rrugës asfalti është duke u shembur, dhe janë berë disa gropa me të vërtetë të mëdha dhe nuk e di a i keni parë?

z.Ruzhdi Shehu, po është e vërtet kjo që e thatë, i kemi evidentuar ato dëme por nuk mund të themi se nesër do riparojmë, por do te jenë pjesë e projektit qe vetëm e kemi nënshkruar kontratën me kompanin për riparimin e rrugëve ku janë te dëmtuara, ndërsa sa i përket rrugës për bjeshkë ka shkuar deri ne "Gropë të Erenikut" dhe do te vazhdojë deri ne "Lugun e Gjatë", dhe rruga Junik, Jasiq dhe Gjocaj ka qenë një projekt paraprak i veçant, dhe ne e dimë se ajo rrugë ka pjesë që janë shembur, projekti ka ndryshuar dhe në atë pjesë është propozuar që të futen pilotat, që të ruhet siguria në atë pjesë të rrugës, te gjitha këto masa do të mirren dhe nuk do të shtrohet as me shumë dhe as me pak pa u bërë pilotimi, do te bëhen 75 pilotime, këto pilotime do te japin stabilitet dhe siguri rrugës.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese tjetër nuk ka , kalojmë ne pikën e radhës se ditës.

5. Shqyrtimi dhe Miratimi i Propozim Vendimit për Taksa Komunale te ndërtimit për Vitin 2026,

Sqarimin dhe arsyetimin për propozim vendimin për taksa komunale të ndërtimit per vitin 2026 e beri z.Zenun Shala- drejtor ne DUKM.

z.Shpejtim Gacaferi, pyetje nuk ka e qes ne votim propozim vendimim per taksa komunale të ndërtimit për vitin 2026, presezent në sallë janë tetë (8) anetarët e kuvendit , kush është për? për 8 vota, kundër dhe abstenim 0 vota, konstatoi se vendimi u miratua.

6. Informatë mbi Raportin e Përfomancës së Administratës së Komunës së Junikut për vitin 2025,

Informatën e bëri znj. Leonora Shehu- drejtoreshë në AD, e cila fillimisht i përshëndeti të gjithë me pas informoje kuvendin mbi raportin e përfomances së Administratës së Komunës së Junikut për vitin 2025.

z. Shpejtim Gacaferi, pyetje nuk ka kalojmë në pikën e radhës së ditës.

7. Shqyrtimi i raportit dhe Analiza e vitit Shkollor 2024/2025,

Shqyrtimin dhe aryetimin e raporti dhe analizat e vitit shkollor 2024/2025 e bëri z. Xhavit Velijaj- drejtor në DAKRS.

z. Zenel Maloku, kryesues me qenëse kemi shumë pika të rendit të ditës kisha propozuar që ta kemi një pauzë prej pesë (5) minuta.

z. Shpejtim Gacaferi, në rregull pauzë prej pesë (5) minuta.

Pas pauzës

z. Shpejtim Gacaferi, pyetje rrethë raportit dhe analizës së vitit shkollor 2024/2025 nuk ka, kalojmë në pikën e radhës së rendit të ditës.

8. Shqyrtimi dhe Miratimi i Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë,

z. Shpejtim Gacaferi, meqenëse ka shumë material nuk e kisha mundur drejtorin për sqarim kështu që e qes në votim, prezent në sallë janë 8 anëtarët e kuvendit, kush është për? për 8 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se plani komunal të veprimit për energji dhe klimë u miratua.

Ndërhyrje nga z. Lulzim Gacaferi, pse gjithë kjo nguti kryesues, unë po dua ta ndëgjoj sqarimin rreth këtij plani nga drejtori e më pas të votoj.

Sqarimi nga z. Demokrat Ganijaj-drejtor i DSHP<SI i cili fillimisht i përshërshendeti më pas e sqaroi dhe e arsyetoj para anëtarëve të kuvendit planin komunal të veprimit për energji dhe klimë.

9. Rishqyrtimi i Vendimit me nr:02-180/4898 për zgjerimin e Zonës Urbane në Komunën e Junikut, Miratuar nga Kuvendi Komunal Junik, dt:27.06.2025,

Sqarimin rrethë shfuqezimit të vendimit e bëri z. Shpejtim Gacaferi- Kryetar i Kuvendit të Junikut.

z. Lulzim Gacaferi, pse duhet ta anulojmë këtë vendim, unë personalisht po flas se nuk e votoj këtë shfuqezim të këtij vendimi, nuk pajtona me ata që e kanë kthyer këtë vendim, për arsye se në atë pjesë parashihet të investohen miliona euro dhe është në dobi të zhvillimit të Komunës së Junikut andaj unë dhe kolegja ime, jemi kundër shfuqezimit të këtij vendimit.

z.Shpejtim Gacaferi, po e lexojë në tansi të vendimit që kemi marë nga ministria për ligjshmërinë e vendimit 02-180/4898 të datës 27.06.2025, pason leximi.

z.Lulzim Gacaferi, pavarisht asaj se çka ka kthyer ministria unë jam kundër shfuqëzimit të këtij vendimi.

Z.Ruzhdi Shehu, të gjitha vendimet që u nxjerrin si komunë i nënshtrohen një kontrole ligjore tek niveli i qeverisë qendrore, ju e dini se edhe më parë kemi marë një vendim që ka qenë i kundërligjshëm dhe na është dashtë të meremi dhe ta rishqyrtojmë, dhe janë shkelje ligjore të mandatit dhe të komisioneve të kuvendit, për ti ndimuar kesaj qeshtje do të ishte i udhës që vendimi të shfuqëzohet dhe kur të rishikohet PZHK_ja të kërkojmë që të zgjerohet zona e zhvillimit, me mos shfuqëzimin e vendimit në i bëjmë dëme investitorit dhe po ashtu edhe komunes.

z.Sadri Krasniqi, përshendetje për të gjithë, u shpjegua qartë kjo qeshtje, ne po e shfuqëzojmë vendimin, a mundemi ne si komune ne të ardhmen ta zgjerojmë zonën në mënyrë që ti ndimojmë investitorit, edhe une jame me atë që e thote z.Lulzim Gacaferi sepse ne me dëshirë e kemi votuar atë vendim, por tash jemi ne ketu ku jemi dhe ne si kuvend të zgjedhim rrugën se ka i ndimojmë më shumë kesaj qeshtje,

z.Shpejtim Gacaferi, me e shfuqëzu Vendimin.

z.Lulzim Gacaferi, unë po ju kuptoj por për sot unë e kam votën kundër shfuqëzimit të këtij vendimi, kështu që propozoj që kjo pikë të shtyhet për një mbledhjet të jashtëzakonshme ose për mbledhjen e radhës.

z.Zenel Maloku, tek e fundit, lënda shkon në prokurori, prokuroria në gjykatë drejteësi në fund drejtësisë nuk mundemi me ikë, edhe unë nuk e votoj shfuqëzimin e këtij vendimi.

z.Shpejtim Gacaferi, në rregull ne po e shtymë këtë pikë, por me vetëdije a pa vetëdije ne jemi ka e dëmtojmë këtë operator.

10. Shqyrtimi i kërkesës për faljen e borxheve të biznesëve nga taksa e veprimtarisë,

Sqarimin dhe arsyetimin e kërkesës e bëri z.Ruzhdi Shehu- Kryetar i Komunës së Junikut.

z.Sadri Krasniqi, unë e përgezoj kryetarin për këtë iniciativë, është kërkesë e qëlluar, bile sa do pak të ju ndihmojmë biznset që të kryejnë veprimtarinë në komunën e Junikut.

z.Lulzim Gacaferi, unë e përgezoj kryetarin e Komunës për këtë iniciativë, ndoshta ndonjë biznes i madh nuk do ta kishte të vështirë që ta paguaj këtë taksë por bizneset e vogla po, andaj edhe pse nuk e di se sa biznese të mëdha e të vogla lirohen nga këto borgje e kjo taksë unë jam prap për shlyerjen edhe heqjen e kësaj takse.

z.Shpejtim Gacaferi, pyetje nuk ka e qes në votim kërkesën për faljen e borxheve të biznesëve nga taksa për veprimtari, kush është për? për 7 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, unë nuk votoj për shkak të konflikti të interesit, konstatoi se kërkesa u miratua.

11. Shqyrtimi dhe Miratimi i Planit për Trashëgimin Kulturore 2025-2030,

Sqarimin dhe arsyetimin e kësaj pike të rendit të ditës e bëri z/Xhavit Velijaj- drejtor në DAKRS.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese nuk ka e qes në votim plani për trashëgiminë kulturore 2025-2030, kush është për? për 8 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se plani kulturor u miratua.

Për shkak të kohës i kemi dy kërkesa të drejtorisë së arsimit i kishim shqyrtuar të dyjat bashkë, të njëjtin qëllim e kanë.

12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë së Arsimit për themelimin e Institucionit parashkollor,

13. Shqyrtimi dhe miratimi për formimin e komisionit prej dy anëtarëve për zgjedhjen e drejtorit në institucionin parashkollor.

Sqarimin dhe arsyetimin për këto dy pika të rendit të ditës i bëri z.Xhavit Velijaj-Drejtor në DAKRS,

z.Shpejtim Gacaferi, pyetje nuk ka, e qes në votim të dy pikat të rendit të ditës, kush është për? për 8 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se kërkesa për themelimin e Institucionit parashkollor dhe formimi i komisionit prej dy anëtarëve për zgjedhjen e drejtorit për institucionin parashkollor u miratua.

14. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit

Pyetje nuk ka.

15. Të ndryshme

z/Lulzim Gacaferi, çështja që do ta ngriti këtu ka të bëjë me sigurinë, në sallë nuk është komandanti i policisë që të ndegjojë këtë çështje por mendoj se ky shqetësim do të meret seriozisht nga zyrtarët komunal po ashtu edhe nga policia e Kosovës stacioni i Junikut, tash që kemi fluks të madh të ardhjes së mërgimtarëve dhe ka një komunikacion të stërmbushur, dua nga policia e Kosovës të shtojë kontrollat nëpër rrugë sepse janë duke i ngasur makinat me shpejtësi të lartë.

z.Zenel Maloku, me datën 28 keni mbajtur një akademi perkujtimore, për heronjtë e luftës së Zharres, kta heronjë e dhanë me të qmuaren për këtë liri që ne gëzojmë dhe e jetojmë, komuna akoma nuk ka ndërtuar një rrugë për ta, komuna nuk ka ndërtuar një rrugë për këta tre heronjtë në vendin ku e ka dhënë jetën, për mua kjo është e tmerrshme pa marrë parasysh se kush është

Kryetar Komune, andaj unë kërkoj nga Kryetari i Komunës që të ndërtojë një rrugë deri te vendi ku janë ra këta heronjë.

z.Ruzhdi Shehu, sa për informatë ne vetëm e kemi futur në plan program këtë rrugë dhe kjo rrugë do të ndërtohet.

z.Shpejtim Gacaferi, e shpalli te mbyllur mbledhjen e Korrik-2025

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha



Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi

